

## KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTE)

Sot më datë 15/04/2021 mes palëve të mëposhtme kontraktuese lidhet kjo kontratë shitblerje kuote:

**Shitësi:** **Z. Marin Gjonaj**, i biri i Besnikut, lindur më datë 30.08.1985 në Tiranë dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga "Sami Frashëri", 56, Shk.D, Ap 2/3, Tiranë, mbajtës i Pasaportës shqiptare me Nr. BR9864209 dhe Nr. Personal I50830192B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë "AMB Construction" shpk, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nr. Nuis L81520023N; (referuar me poshtë si **Shitësi**)

**Blerësit:** **Shoqëria AGNA SHA**, shoqëri aksionare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT J62903631L, me seli në adresën: Vrisera, Gjirokastër, , përfaqësuar nga Administratori z. Kristo Naçi, sipas Vendimit të Asamblesë së Aksionarë nr. 159 datë 14.04.2021; dhe

**Shoqëria Tirana International Development SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT J82427007R, me seli në adresën: Njësia bashkiake nr 5, rruga Sami Frashëri, nr 56, shkalla F, kati 1, zyra 2, nr pasurie 7/630- N30, (pjesa prej 71.5 m), zona kadastrale 8270, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori z. Behar Male, sipas Vendimit të Ortakut të vetëm datë 14.04.2021; dhe

**Shoqëria INFO-Telecom SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT K92402002P, me seli në adresën: Rruga e Elbasanit, Objekti Park, Gate, Kati i I-rë, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori z. Marin Gjonaj, sipas Vendimit të Ortakut të vetëm datë 14.04.2021, (referuar më poshtë si **Blerësit**)

**Bashkërisht referuar në këtë kontratë si "Palët"**

### **PREMISA:**

- A. Shoqëria "AMB Construction" shpk, është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Nr. NUIS L81520023N. Kapitali i shoqërisë "AMB Construction" shpk është ALL 100.000 (njëqind mijë lekë) Lekë, i përbërë nga një kuotë.
- B. Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë "AMB Construction" shpk dhe zotëron 100 % (njëqind përqind) të pjesëmarrjes së tij na kapitalin e saj të përbërë nga 1 (një) kuotë. Ai dëshiron t'i shesë kuotën e tij blerësve sipas kushteve dhe pjesëve të përcaktuara në këtë kontratë. Duke qenë se shitësi është ortak i vetëm në shoqërinë AMB Construction shpk,



*shitja e kuotës nuk shoqërohet me miratimin e vendimit të Asamblesë së Ortakëve në rastin kur shoqëria zotërohet nga një ortak i vetëm.*

C. Secili prej Blerësve dëshiron të blejë pjesë të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk sipas përcaktimit të kësaj kontrate dhe kushteve të saj.

Në përputhje me nenin 73: "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare», i ndryshuar, neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, si dhe në Statutin të Shoqërisë "AMB Construction" sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

### Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja nga ana e shitësit tek blerësi:
  - a. Shoqëria AGNA SHA të 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk;
  - b. Shoqëria Tirana International Development SHPK të 20% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk;
  - c. Shoqëria INFO-Telecom SHPK të 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk.
- 1.2 Blerësit deklarojnë se pranojnë të blejnë nga shitësi kapitalin e shoqërisë AMB Construction shpk sipas pjesëve të cituara në pikën 1.1 të këtij kundrejt çmimit të vendosur nga palët në nenin 2 të kësaj kontrate.

### Neni 2 Çmimi i Shitjes

- 2.1 Çmimi për blerjen e kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk është:
  - a. Çmimi i shitjes së 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk tek blerësi shoqëria AGNA SHA është ALL 40,000 (dyzetë mijë lekë);
  - b. Çmimi i shitjes së 20% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk tek blerësi shoqëria Tirana International Development SHPK është ALL 20,000 (njëzetë mijë lekë);
  - c. Çmimi i shitjes së 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk tek blerësi shoqëria INFO-Telecom SHPK është ALL 40,000 (dyzetë mijë lekë).
- 2.2 Shitësi dhe secili prej Blerësve deklarojnë se çmimi i shitjes është paguar plotësisht nga secili prej Blerësve në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 2.3 Titulli i pronësisë mbi secilën pjesë të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk do të transferohet nga Shitësi tek secili prej Blerësve në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe.
- 2.4 Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, secili Blerës fiton përkatësisht të drejtën e pronësisë mbi pjesën e kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk të blerë nga

- shitësi, ndërsa Shitësi zhvishet nga çdo e drejtë pronësie mbi të gjithë kapitalin e kësaj shoqërie dhe të drejtat që rrjedhin prej saj.
- 2.5 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kapitali i shoqërisë AMB Construction shpk do të ndahet në 3 (tre) kuota dhe do të zotërohet si më poshtë:
- Shoqëria AGNA SHA do të zotërojë 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk të përbërë nga një kuotë;
  - Shoqëria Tirana International Development SHPK do të zotërojë 20% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk të përbërë nga një kuotë;
  - Shoqëria INFO-Telecom SHPK do të zotërojë 40% të kapitalit të shoqërisë AMB Construction shpk të përbërë nga një kuotë.
- 2.6 Me nënshkrimin e kësaj kontrate autorizohet Administratori ose persona të autorizuar prej tij të kryejë/në procedurat e regjistrimit të këtij veprimi juridik në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### Neni 3 Garancitë

- 3.1 Shitësi është pronar i ligjshëm i 100 % (njëqind përqind) pjesë të kapitalit të shoqërisë "AMB Construction" sh.p.k, të përbërë nga 1 (një) kuotë të cilën do ta kalojë në pronësi të blerësve sipas pjesëve dhe përcaktimeve të përshkruara më sipër në këtë kontratë.
- 3.2 Shitësi garanton Blerësit që kapitali i shoqërisë AMB Construction shpk, është krejtësisht i lirë dhe nuk është vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.
- 3.3 Palët deklarojnë dhe garantojnë se duke lidhur dhe zbatuar këtë Kontrate nuk vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore, kontraktuale apo statutore, kur është e zbatueshme.
- 3.4 Shitësi deklaron se shoqëria AMB Construction shpk (ish Macom SHPK) ka patur ndaj subjekteve të treta këto detyrime:
- Detyrimi ndaj shoqërisë INFO – Telecom shpk në vlerën prej EUR 20,000 (njëzet mijë euro) sipas kontratës së huas datë 22.02.2021 dhe ALL 72,130 (shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë mijë lekë). Ky detyrim si dhe interesat e llogaritura mbi të është falur tërësisht nga shoqëria INFO – Telecom shpk sipas marrëveshjes së faljes së detyrimit të lidhur ndërmjet palëve;
  - Detyrimi ndaj shoqërisë ENER TRADE shpk në vlerën prej EUR 20,000 (njëzet mijë euro) sipas kontratës së huas datë 03.07.2020. Ky detyrim si dhe interesat e llogaritura mbi të është falur pjesërisht nga shoqëria ENER TRADE shpk në vlerën EUR 8,626 (tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë euro) sipas marrëveshjes së faljes së detyrimit të lidhur ndërmjet palëve. Detyrimi aktual që shoqëria AMB Construction shpk ka ndaj shoqërisë ENER TRADE SHPK është në vlerën EUR 11,374 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e katër euro);
  - Detyrimi që shoqëria AMB Construction shpk (ish Macom SHPK) ka ndaj ortakut të vetëm deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate z. Marin Gjonaj,



Arifkeho Braho Uka 

në vlerën ALL 1,631,595.2 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë presje dy lekë). Ky detyrim është falur nga ortaku z. Marin Gjonaj sipas marrëveshjes së faljes së detyrimit të lidhur ndërmjet tij dhe shoqërisë AMB Construction shpk (ish Macom SHPK).

#### Neni 4 Regjistrimi

- 4.1 Regjistrimi i transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) kryhet në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 «Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit».

#### Neni 5 Ligji i zbatueshëm

- 5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare», ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 «Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë», Ligji «Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit», si dhe Statuti i Shoqërisë «AMB Construction» sh.p.k.

#### Neni 6 Juridiksioni

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

#### Neni 7 Dispozita të fundit

- 7.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.  
7.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.  
7.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e palëve, duke respektuar formën shkresore.

Kjo kontrate u përpilua në 4 (katër) kopje me vlerë të barabartë ligjore. Palët deklarojnë se njohin dhe kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kësaj kontrate. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët.

PALËT



4

Anxhela Beshollari  
03

**SHITËSI**  
**Z. MARIN GJONAJ**


*Marin Gjonaj*

**BLERËSIT**

**Shoqëria AGNA SHA**

Përfaqësuar nga Administratori z. Kristo Naçi

*Kristo Naçi*



**Shoqëria Tirana International Development SHPK**

Përfaqësuar nga Administratori z. Behar Male

*Behar Male*

**TIRANA INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT  
TIRANA ALBANIA**

**Shoqëria INFO-Telecom SHPK**

Përfaqësuar nga Administratori z. Marin Gjonaj

*Marin Gjonaj*



*Anxhela Babolloni*